

V E N D I M
Nr.302, datë 15.5.2003

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-
HERCEGOVINËS, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS MBI HEQJEN E VIZAVE
PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës, më tej referuar si Palët:

duke shprehur dëshirën e përbashkët për të zhvilluar më tej marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy shteteve;

duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre, ndërmjet dy vendeve,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e dy Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtën e hyrjes, daljes ose lëvizjes transit në territorin e vendit tjetër pa vizë.

Ata gëzojnë të drejtën e qëndrimit deri në 90 ditë nga momenti i mbërritjes.

Neni 2

1. Qytetarët e njërës prej Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të vlefshëm, të punësuar në misionet diplomatike ose konsullore dhe organizata ndërkombëtare, të akredituara në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të marrin lejen e qëndrimit nga vendi pritës pas hyrjes, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre. Në vazhdim të kryerjes së detyrimeve të tyre në misionet diplomatike ose konsullore dhe/ose organizatat ndërkombëtare, këta persona do të jenë të lirë të hyjnë dhe të dalin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Gjithashtu dispozitat e paragrafit të parë do të zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre, të cilët bashkëjetojnë me ta në të njëjtin vend dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e qytetarëve të të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit në territorin e vendit tjetër, duhet të bëhet nëpërmjet pikave kufitare zyrtare të të dy vendeve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk përjashton qytetarët e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Nga ana tjetër, kjo Marrëveshje i jep të drejtën çdo vendi të refuzojë hyrjen dhe/ose të ndalojë qëndrimin e qytetarëve të vendit tjetër në territorin e vet, nëse ato kryejnë veprime që thyejnë këto ligje dhe/ose rregulla.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk cenon ligjet dhe/ose rregullat me karakter të përgjithshëm në fuqi në të dy vendet në lidhje me sigurinë kombëtare, si dhe ato që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin dhe lëvizjen e një qytetari të Palës tjetër, i cili mund të konsiderohet një person non grata.

Neni 6

Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi ndryshimin e këtyre specimeneve 30 ditë, përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi.

Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë specimenet e reja ose të ndryshuara të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit duke përfshirë të dhëna lidhur me përdorimin e tyre para prezantimit të këtyre specimeneve.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që mund të ngrihen në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë nga data e njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilës Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të pacaktuar dhe do të jetë e vlefshme, deri sa njëra Palë njofton vendimin e saj për ta denoncuar nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të shfuqizohet 30 ditë pasi Pala tjetër ka marrë njoftimin.

Kjo Marrëveshje mund të shtohet ose ndryshohet me pëlqimin e përbashkët të Palëve, nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike.

Bërë në Sarajevë, më 15 prill 2003 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.